



Qendra për Kërkim  
dhe Zhvillim

# **SLLOVENIA, NGA JUGOSLLAVIA NË BASHKIMIN EVROPIAN**



Komisioni Evropian

## **Rreth autorit**

### **Grupi i punës:**

Mirlinda Rusi (M.A. Integrimi Evropian), Drejtore Ekzekutive, QKZH Tiranë,  
Dr. Ledia Muço, Rozi Beqiri (përpunim informacioni), Komola Sako, QKZH Tiranë.

### **Qendra për Kërkim dhe Zhvillim**

QKZH, Tiranë është organizatë jo fitimprurëse e regjistruar në Gjykatën e Tiranës në mars të vitit 2001. Qëllimi i QKZH është të mbledhë, përpunojë dhe analizojë të dhëna mbi ecurinë e sektorit privat dhe publik. Ajo ka si objektive të ndihmojë institucionet publike dhe komunitetin e biznesit në hartimin e politikave të drejta për zhvillimin e biznesit dhe përmirësimin e menaxhimit të buxhetit.

### **Adresa:**

Qendra për Kërkim dhe Zhvillim  
Rr. Luigj Gurakuqi P.15/1, Sh.1, Ap.1  
P.O.Box: 218/1  
Tiranë, Shqipëri

Tel +355 4 230445

Internet: [www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)  
E-mail: [qkzhtir@icc-al.org](mailto:qkzhtir@icc-al.org)

Layout: Rozi Beqiri

Shtypur në shtypshkronjën: albPAPER

Ky dokument botohet me mbështetjen financiare të Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjëshmëri vetëm e Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron qëndrimin e Unionit Evropian.

# Lënda

---

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>5</b>
<b>2. Sfidat e tranzicionit .....</b>	<b>6</b>
<b>3. Politika Makroekonomike dhe Reformat Strukturore...</b>	<b>8</b>
<b>4. Sfidat për të ardhmen.....</b>	<b>13</b>
<b>4.1 Kostot dhe Përfitimet nga anëtarësimi në BE.....</b>	<b>15</b>
<b>4.2 Efekti i integrimit në BE fokusuar tek e ardhmja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.....</b>	<b>19</b>
<b>4.3 Madhësia e shtetit aderues dhe rëndësia e tij në anëtarësimin në BE.....</b>	<b>21</b>
<b>Tabela 1: Tregues të caktuar të Ekonomisë Sllovene në vitet 1991-2004.....</b>	<b>26</b>
<b>Tabela 2: Prodhimi industrial si pjesë e PBB-së.....</b>	<b>27</b>
<b>Tabela 3: Prodhimi Bujqësor si pjesë e PBB-së.....</b>	<b>28</b>



## 1. HYRJE

Kjo broshurë është përpunuar nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim mbi bazën e përzgjedhjes së librit me titull në origjinal “Slovenia”, të autorëve Mojmir Mrack, Matija Rojec, Carlos Silva Juregui, botuar në vitin mars.

Nëpërmjet kësaj broshure ne kërkojmë që lexuesi shqiptar të gjejë përgjigjen e pyetjeve: përse zgjidhet eksperiencia Sllovene për sytë e lexuesit Shqiptar dhe cilat janë sfidat që kaloi Sllovenia derisa u anëtarësua në Bashkimin Evropian.

Eksperiencia Sllovene është e veçantë përse i përket dimensioneve të tranzicionit që kaloi, që me krijimin e saj e më pas me konsolidim e deri me integrimin në BE. Nga ana tjetër, pozicioni i saj në rajon, veçoritë gjeografike dhe të popullsisë, karakteristikat e një ekonomie që vinte nga një sistem i planifikuar/centralizuar drejt një ekonomie tregu, dhe aspiratat e vendit drejt Bashkimit Evropian e bëjnë këtë model interesant dhe të vlefshëm për t’u studiuar në lidhje me zhvillimet paralele në Shqipëri.

Shqipëria si një vend që aspiron integrimin në BE, dhe që ka nënshkruar marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në 2005, vlen të studiojë nga afër eksperiencën Sllovene, përse i përket procesit parapërgatitor të asociimit në BE, si dhe sfidave me të cilat u përball dhe politikat e ndjekura. Nga ana tjetër, njohja e përfitimeve dhe kostove nga anëtarësimi në BE, do të lehtësonte edhe ndërmarrjen e vendimeve strategjike dhe politikave që do të zbusnin efektet negative, dhe do të gjenin një vend të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Ne besojmë se kjo broshurë do të jetë e vlefshme për të gjithë nivelet e lexuesve si studentë, studiues të historisë, ekonomistë dhe të gjithë ata të cilët dëshirojnë të kenë njohuri mbi historikun e integrimin të fqinjëve tanë në tranzicion.

I japim falenderimet dhe mirënjohjen tonë bashkëpunëtorëve tanë të ngushtë si dhe financuesit të këtij projekti, Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri, në kuadrin e projektit “Debati studentor në lidhje me çështjet e BE dhe perspektiva e Shqipërisë në BE”.

## 2. SFIDAT E TRANZICIONIT

Gjatë 13 viteve të para si një shtet i pavarur modern, Sllovenia kaloi një tranzicion tre dimensional. Kështu, përveç tranzicionit nga regjimi socialist në ekonominë e tregut, një tranzicion të cilin Shqipërise iu desh ta kalonte për më shumë se 10 vjet, Sllovenia u përball me tranzicionet paralele nga një ekonomi rajonale në një ekonomi kombëtare dhe nga të qëniet pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë në një shtet të pavarur dhe që aspironte për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Fakti që përpara 1991 Sllovenia ishte pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë kishte dy impakte të rëndësishme për konceptin Slloven të reformave dhe proceseve që i shoqëronin. Gjatë dekadave të para të pavarësisë, Sllovenia ishte pjesë e një sistemi socialist unik të tregut ku reformat e tranzicionit filluan që në fund të viteve 1980, dhe që përfunduan në kolapsin e Federatës Jugosllave. Si pjesë e një federate të madhe, Sllovenia ishte e detyruar të ndiqte modelet e zhvillimit të federatës. Gjatë vitetve 1980 filluan të shtohen kontradiktat ndërmjet këtyre modeleve si dhe aspiratat e zhvillimit të Sllovenisë si pjesa me e zhvilluar e Federatës Jugosllave.

Procesi i reformave të Sllovenisë bazohej në dy shtylla kryesore politike: së pari, ajo lidhej me politikën që synonin stabilizimin makroekonomik dhe liberalizimin e brendshëm dhe të jashtëm. Së dyti, ajo lidhej me reformën strukturore dhe institucionale, duke përfshirë ndërmjet të tjerave krijimin e institucioneve, privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe reformën në sektorin e ndërmarrjeve, sektorin financiar, të shërbimeve publike, pensioneve dhe sistemit tatimor (*ngjashmëria me Shqipërinë*).

Tre tiparet dalluese të tranzicionit në Slloveni

Tre tiparet dalluese që karakterizojnë tranzicionin në Slloveni në krahasim me vendet e tjera që dilnin nga regjimi komunist dhe planifikimi i centralizuar janë:

- Sllovenia zgjodhi një drejtim gradual të tranzicionit – (*Shqipëria ndoqi terapinë e Shokut*)

- Tranzicioni i Sllovenisë nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi tregu u shoqërua me një tranzicion nga një ekonomi rajonale në një ekonomi kombëtare (eksperiencë e ndryshme me Shqipërinë)

- Sllovenia trashëgoi nga ish Jugosllavia një strukturë pronësie të ndërmarrjeve që ishte e veçantë e që bazohej në vetë-administrimin dhe në një organizim institucional të veçantë si dhe pronën shtetërore. (*Shqipëria por edhe vende të tjera hynë në tranzicion me një strukturë pronësie të dominuar nga shteti.*)

Avantazhi kryesor i drejtimit të një tranzicioni gradual- krahasuar me drejtimin big bang, ishte se vendet ku tranzicioni ndoqi drejtimin e dytë, u shoqërua me pasoja shoku ekonomikë, duke çuar në mjaft raste në rënie të mëdha të produktit të përgjithshëm dhe rritje të papunësisë dhe si rrjedhim të paqëndrueshmërisë sociale, që tek e fundit do të vënë në pikëpyetje vetë reformat e ndërmarra (*Rasti i Shqipërisë*).

Politikanët e rrymës gradualiste të tranzicionit mendojnë se ky drejtim do të lejonte që të ri-alokoheshin ca aktivitete ekonomike dhe vende pune ndërmjet firmave dhe industrive, se sa të sillnin humbjen e të tërave.

Arritja më e madhe e Sllovenisë gjatë dekadës së fundit, ndërkohë që ishte në listën e vendeve kandidatë për në BE ishte norma më e lartë e rritjes ekonomike. Për më tepër, pas stabilizimit fillestar të treguesve makroekonomikë, rritmet e saja e larta të rritjes u arritën pa disbalanca të ndjeshme makroekonomike gjatë viteve '90, dhe pothuajse e njëjta gjë mund të thuhet për zhvillimet sociale dhe politike. Sidoqoftë, politika gradualiste duket se është një alternativë vetëm për ekonomitë well-off dhe mund të mos jetë një alternative për shumë ekonomi të tjera në tranzicion.

Është e qartë se qëndrueshëria ekonomike, sociale dhe politike e procesit të reformave ka qenë një përfitim i qartë për gradualizmin në Slloveni.

### *Po përse u zgjodh sistemi gradualist?*

Konsensusi i fortë politik dhe tradita në reformat ekonomike ishin arsye kryesore përse ishte e natyrshme që të zgjidhej ky sistem reformash të tranzicionit në fillimet e tij. Por sidoqoftë, sipas analistëve, zhvillimet në vitet e fundit para hyrjes së Sllovenisë në BE kanë treguar se vazhdueshmëria e një drejtimi gradualist mund të rrezikojë seriozisht konkurrueshmërinë dhe madje të dëmtojë stabilitetin makroekonomik që ishte i vlerësuar deri atëherë.

### **3. POLITIKA MAKROEKONOMIKE DHE REFORMAT STRUKTURE**

Me fitoren e pavarësisë, Sllovenia trashëgoi një situatë të vështirë ekonomike, qoftë përsa i përket situatës hiper-inflacioniste, ashtu edhe borxhit të jashtëm.

Në të njejtën kohë, Sllovenia humbi tregje nga Federata e Jugosllavisë, nuk kishte rezerva në valutë të huaj për të mbajtur në kontroll valutën vendase dhe sapo kishte filluar të zbatonte një politikë të ekonomisë së hapur të orientuar drejt eksporteve, e cila kërkonte liberalizimin e transaksioneve me jashtë. Për të gjitha këto arsye stabilizimi makroekonomik dhe liberalizimi i tregut ishin nevojat absolute dhe prioritetet e periudhës së parë të tranzicionit në Slloveni.

Suksesi në reformat e liberalizimit të tregut dhe stabilizimit makroekonomik bënë të mundur që në vitin 1993 të ndërmerreshin reformat strukturore dhe institucionale, që lidheshin me politikat monetare, fiskale, të të ardhurave dhe Politikat e tregëtisë.

#### *Politika fiskale*

Një llogari fiskale e balancuar dhe krijimi i mjedisit fiskal të aftë për të nxitur rritjen ekonomike ishin objektivat kryesore të politikës fiskale Sllovene. Reformimi i institucioneve të financave publike në vitin 1991 solli përmirësim të situatës fiskale, duke sjellë rritje të efektivitetit të mbledhjes së taksave dhe përmirësoi kontrollin e shpenzimeve publike. Së bashku krijuan bazat për tranzicionin e Sllovenisë në një ekonomi tregu dhe siguruan mbështetje për politikat monetare në stabilizimin e ekonomisë.

#### *Politika Monetare*

Gjatë fillimeve të tranzicionit, politika monetare e Sllovenisë u përqëndrua në dy drejtime kryesore: në futjen e monedhës së re Tolari Slloven, për t'u identifikuar ndryshe nga ish Republika Federative e Jugosllavisë; dhe në stabilizimin e çmimeve. Arritjet e para të politikës efektive monetare mund të vërehen në 1995, kur Sllovenia kishte një valutë të sajën të konsoliduar në treg, kur rezerva valutore e huaj kishte filluar të rritej dhe norma e inflacionit ishte vendosur në kontroll. Këto

rezultate të para të reformës në politikën monetare bënë që në vitin 2003 e më vonë Sllovenia të kishte një bilanc të pagesave të përmirësuar ndjeshëm, normat e interesit të ulura dhe një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar në lidhje me stabilitetin e sektorit Bankar.

### *Politika e të ardhurave*

Politika e të ardhurave është e rëndësishme për çështje të stabilizimit makroekonomik, punësimit dhe konkurrueshmërisë së eksporteve për vende të vogla si Sllovenia. Që nga koha kur fitoi pavarësinë Sllovenia krijoi mekanizmat institucionalë në të cilët marrëveshjet kolektive janë aparatet bazë të përcaktimit të pagës dhe ku legjislacioni luan një rol të rëndësishëm.

Marrëveshjet sociale tri-partiake ndërmjet qeverisë, sindikatave dhe punëdhënësve krijojnë një mekanizëm uniform për përshtatjen e pagave. Sidoqoftë, këto marrëveshje nuk kanë qënë të mjaftueshme për të kontrolluar rritjen e pagave. Indeskimi i pagave ka ndryshuar disa herë, duke u nisur nga rregullime mujore dhe tremujore në varësi të çmimeve deri tek ndryshime më të pakta dhe pjesore dhe nga ex post në ex ante. Mbas këtyre zhvillimeve, vlen të përmendet vendimi i rëndësishëm i marrë në vitin 1997 për indeksimin e pagave një herë në vit, dhe zëvendësimi i metodës së vlerësimit ex post me ex ante në vitin 2001, në përputhje me Indeksin e Çmimeve të Konsumit

Deri në vitin 1996, politika e pagave në Slloveni nuk e mbështeste shumë politikën e stabilizimit. Rritjet e vazhdueshme të pagave të punonjësve për punëtorët ndikuan negativisht në aftësinë konkurruese të eksporteve të vendit. Pavarësisht rënies së induktuar të punësimit për shkak të tranzicionit, rritja e pagave reale për punonjësit solli rritje të produktivitetit të punës. Vetëm në vitin 1997 si rezultat i një mekanizmi indeksimi të ri, rritja e pagave u ngadalësua. Vendosija në kontroll e rritjes së pagave në sektorin publik mbetet ende një objektivi që duhet arritur në të ardhmen.

### *Politika tregtare*

Për shkak të madhësisë së vogël gjeografike, Sllovenisë i interesonte të zhvillonte një politikë të hapur ndaj vendeve të tjera, duke synuar zhvillimin e eksporteve dhe politikave që promovonin eksportin.

Që nga viti 1991 pjesa e tregtisë së jashtme në PBB është përmirësuar ndjeshëm. Partnerët kryesorë të Sllovenisë janë dhe do të mbeten Shtete fqinje Evropiane, kryesisht anëtare të BE-së. Sllovenia ndërmori një sërë reformash e politikash tregtare që synonin të ri-orientonin strategjinë e subvencionimit të importeve me një strategji të orientuar drejt eksporteve. Që me fitoren e pavarësisë, Sllovenia ka ndjekur disa reforma tregtare (ulja e taksave doganore, eliminimi apo reduktimi i barrierave jo-tarifore) me qëllim që të rritej shkalla e hapjes së ekonomisë me ekonominë ndërkombëtare, dhe të ngriheshin mekanizmat institucionalë për të siguruar konkurrueshmërinë e produkteve vendase. Sot Sllovenia është anëtare e OBT-së dhe anëtare e BE-së.

### *Reformat strukturore dhe institucionale.*

Për të zhvilluar një ekonomi të fortë, që të jetë e aftë t'i bëjë ballë "shokut" të tranzicionit dhe për të ulur normën e inflacionit në nivele të kontrollueshme, politikat makroekonomike duhet të shoqërohen me një sërë reformash institucionale dhe strukturore. Në Slloveni këto reforma synonin *së pari*, që të krijonin kushtet bindëse për thithjen e investimeve të huaja, aq të nevojshme për një rritje ekonomike të qëndrueshme, *së dyti*, një rritje të aftësive konkurruese të ekonomisë në tregjet botërore, duke përmirësuar eficiencën e tregut të brendshëm vendas, dhe *së treti*, në hartimin e politikave dhe masave që do të bënin tranzicionin një proces të qëndrueshëm nga pikëpamja sociale dhe mjedisore.

Ky proces reformash institucionale kishte filluar që në vitet 1980 por u përqëndrua më shumë pas fitores së pavarësisë, me procesin e privatizimit, rehabilitimin e sistemit bankar, përshtatjet e rrejtjet të sigurimeve shoqërore dhe iniciativa të tjera. Huaja e marrë nga Banka Botërore në vitin 1993 solli një kontribut të rëndësishëm në arritjen e rezultateve pozitive nga këto reforma. Sllovenia ka bërë njaf progres në reformën strukturore dhe institucionale, por sidoqoftë thellimi i kësaj reforme mbetet një sfidë për të ardhmen e afërt.

### *Ngritja e institucioneve*

Krijimi i institucioneve të përshtatshme është një çështje sa e rëndësishme aq edhe komplekse për vendet që kalojnë tranzicionin nga socializmi në ekonominë e tregut. Kështu në Slloveni, ngritja e

institucioneve ka vijuar në disa drejtime: drejt krijimit të një ekonomie kombëtare dhe shtetërore, drejt tranzicionit nga një sistem socialist në një sistem të ekonomisë së tregut, dhe drejt sistemit të Bashkimit Evropian. Përgjithësisht është mbajtur një qëndrim gradualist gjë që nuk e përshpejtoi shumë ngritjen e institucioneve pas fitores së pavarësisë, por me përfshirjen në reformat për integrimin në BE, masa konkrete për ngritjen e institucioneve u përshpejtuan ndjeshëm.

### *Reforma në sektorin e ndërmarrjeve*

Ristrukturimi i sektorit të ndërmarrjeve filloi në fund të viteve 1980 në Slloveni. Në fazën fillestare, vëmendja kryesore u përqëndrua në tre aspekte të reformës. Së pari, në hartimin e një kuadri ligjor institucional për krijimin e ndërmarrjeve dhe promovimin e iniciativës sipërmarrëse, së dyti, në rehabilitimin e sektorit të ndërmarrjeve drejt së cilës ishin përqëndruar një sërë programesh. Për arsye politike u desh të kalonte një kohë e gjatë deri sa të arrihej në aktin e transformimit të pronësisë në vitin 1992 dhe ndërmarrjet ekzistuese të fillonin të privatizoheshin.

### *Reforma në sektorin financiar*

Ndërmjetësit financiarë në Slloveni janë bankat. Gjatë fillimeve të tranzicionit sektori bankar kaloi një periudhë të rehabilitimit të drejtuar nga qeveria, që u zbatua me sukses deri në 1997. Që atëhere industria bankare ndërmori një konsolidim intensiv dhe me pak ndryshime në strukturë duke synuar në rritjen e eficiencës. Banka më e madhe në Slloveni- Nova Ljubanska Banka u privatizua pjesërisht në 2002 por mbetej kryesisht në pronësi të shtetit<sup>1</sup>. Në të njëjtin vit u lançua edhe privatizimi i bankës së dytë më të madhe në vend, por përpjekjet për privatizim nuk ishin shumë të suksesshme. Sektori i sigurimeve kishte akoma nevojë të konsolidohej e të ristrukturohej, kryesisht për shkak të çështjeve të pazgjidhura të pronësisë në kompanitë më të mëdha të sigurimeve në atë kohë.

Në ndryshim me bankat dhe sistemin e sigurimeve, tregu i kapitaleve në Slloveni paraqitet i çliruar nga probleme të trashëguara

---

<sup>1</sup> Slovenia - nga -Jugoslavia ne Bashkimin Europian, Banka Boterore, 2004

nga e kaluara. Zhvillimi i tregut të kapitaleve u ndikua mjaft nga procesi i privatizimit, por ende nuk është shndërruar në një kanal kryesor për ndërmjetësimin e kursimeve të reja. Kapitalizimi i tregut është i ulët dhe tregtia është përqëndruar në një numër të kufizuar kompanish të mëdha. Reforma e pensioneve me një theks të madh në skemat e financuara ka filluar por efektet e saj pozitive mund të jenë të dukshme vetëm në një moment afatgjatë.

### *Reforma në shërbimet publike dhe përmirësimet në infrastrukturë*

Reformat në sektorin e shërbimeve publike kanë ecur më ngadalë së në sektorët e tjerë, dhe me hapa më të ngadaltë se sa nevojitet për zhvillimin e ekonomisë së tregut. Veçanërisht ajo ishte e ngadaltë në periudhën e parë të tranzicionit dhe më pas me fillimin e procesit për anëtarësim në BE filloi të kishte impakte pak më të ndjeshme.

### *Reforma në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe të pensioneve*

Slllovenia ka patur sukses në mbajtjen e një sistemi sigurimesh shoqërore, shëndetësore dhe të pensioneve në kushte të mira. Reforma e kujdesit shëndetësor daton në vitin 1992 ku u prezantua sistemi vullnetar i sigurimit shëndetësor, i cili pak nga pak mori atributet e një sistemi mandator të detyrueshëm, për shkak të një game të madhe shërbimesh që ofronte. Një tjetër reformë e rëndësishme në sigurimet shoqërore ishte reforma e pensioneve në vitin 2000, e cila kombinoi shtyllën kryesore pay as you go me atë të renë – skemën vullnetare të pensioneve. Me gjithë se këto reforma patën një ndikim pozitiv në stabilitetin fiskal, janë të nevojshme edhe hapa të tjerë me qëllim që të ruhet qëndrueshmëria fiskale afatmesme, veçanërisht po të merret në konsideratë moshja e popullsisë së Slovenisë.

## 4. SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Sfidat për të ardhmen lidhen me anëtarësimin në BE, me vlerësimin gradualist të reformave që duheshin ndjekur, por janë gjithashtu të lidhura me proceset e zhvillimit të Sllovenisë, dhe shkallën e maturimit të ekonomisë pas periudhës së tranzicionit.

Sfida kryesore në fushën e makroekonomisë mbetet vënia në kontroll e normës së inflacionit. Një normë e lartë e inflacionit e shoqëruar me një kurs fiks të këmbimit të tolarit (monedha vendase) në kuadër të sistemit të këmbimit të valutës ERM II mund të shkaktojë probleme të mëdha për vendet e orientuara drejt eksporteve. Por ulja e normës së inflacionit nuk është e vetmja sfidë për Slloveninë. Ajo duhet të punojë për të vënë në zbatim *acqui communitair* (legjislacionin e BE-së) në kuadrin e integritimit në BE<sup>2</sup>.

Menaxhimi i mirë i këtyre dy sfidave do të çonte në sigurimin e stabilitetit makroekonomik. Me hyrjen në sistemin e Euros, Sllovenia do të humbiste pavarësinë e valutës, të cilën e konsideronte si një prej arritjeve të saj në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin gjatë 10 viteve të fundit.

Humbja e pavarësisë së politikës monetare do të nxiste zhvillimin e reformave të tjera makroekonomike të lidhura me politikën fiskale dhe atë të të ardhurave që pavarësisht se mbeten në kompetencat e vendit, duhet të jenë fleksible për t'u përshtatur me direktivat e BE-së.

Nuk ka dyshim që Sllovenia ishte në presion për të përshpejtuar reformën strukturore me qëllim hyrjen në BE dhe më pas në njohjen e unifikimit të valutës pa vështirësi. Për të shmangur situatat e vështira e për të thithur sa më shumë përfitime nga integrimi në BE, ishte e nevojshme të bëheshin më shumë përpjekje në mjaft zona të reformës strukturore me qëllim që të sjellnin dinamizmin dhe rritjen më të madhe ekonomike.

Sipas analistëve, reforma e shërbimeve publike duhej implementuar me një vendosmëri të madhe si politikë financiare ashtu dhe të promovimit të ndërmarrjeve për të krijuar kushte më të favorshme në drejtim të konkurrueshmërinë së sektorit privat. Politika sociale duhej të fokusohet më shumë në përfitimet indirekte përtë ndihmuar më vonë grupet vulnerable si dhe përmirësimi i kuadrit veprimtarisë ekonomike

---

<sup>2</sup> *Sllovenia - nga -Jugoslavia në Bashkimin Europian, Banka Botërore, 2004*

duke u thjeshtëzuar dhe duke u bërë më transparent. Zbatimi i këtyre reformave strukturore do të shoqërohej me një politikë pagash e politikë fiskale shtrënguese (restriktive) për të siguruar një futje të ngadaltë të Sllovenisë në sistemin e Euros ERM II, pas anëtarësimit të Sllovenisë në BE në vitin 2004.

Ashtu si në të kaluarën, nuk ka mungesë njohurish në Slloveni përse i përket asaj se çfarë është e nevojshme për t'u bërë. Ashtu siç përmend Janesz Susteric në kapitullin 24 të Botimit “Sllovenia- nga Jugosllavia në Bashkimin Evropian”, ajo që është e nevojshme tani është vendosmëria për të vepruar për realizimin e atyre synimeve të mira (të zbatohen masat politike për të cilat është rënë dakord) në vend të presionit nga interesa të caktuara dhe në vend të riskut politik të shoqëruara këto me një qëndrim të kujdesshëm për reformat.

Sfidat në reformën strukturore janë më të dukshme në ristrukturimin dhe privatizimin e sektorëve financiar dhe të korporatave si dhe të shërbimeve publike.

## 4.1 KOSTOT DHE PËRFITIMET NGA ANËTARËSIMI NË BE

Sllovenia u anëtarësua në BE në vitin 2004. Rasti i Sllovenisë mund të konsiderohet unik në listen e vendeve që kandidojnë për t'u anëtarësuar për në BE, nisur nga dy drejtime kryesore: *së pari*, ishte vendi me ekonominë më të zhvilluar në tërë rajonin duke realizuar 70% të PBB-së të vendeve të BE-së dhe së dyti, ishte në kushte të tilla zhvillimi që mundi ta menaxhonte pa shumë vështirësi tranzicionin dhe të kapte reformat që e çonin drejt BE-së si nga pikëpamja sasiore dhe ajo cilësore<sup>3</sup>. Këta dy faktorë bënë që në Slloveni të kishte një shkallë më të ulët të një entuziazmi të pakufizuar për hyrjen në BE (rasti i kundërt me Shqipërinë), dhe në të njëjtën kohë të shqetësohej më shumë për masat që duhej të ndërmerre dhe të kishte më shumë besim në vete për mundësitë dhe kapacitetet që kishte për të arritur objektivat.

Vonesat e përsëritura në privatizim, hyrja e ulët dhe e ngadalshme e kapitalit, dobësia e sektorit bankar dhe kostot e larta të prodhimit vendas krahasuar me Republikën Çeke, Hunagrinë, Poloninë dhe Sllovakinë ngushtuan shumë diapazonin e avantazheve krahasuese të Sllovenisë në gjysmën e dytë të viteve 1990 (situatë e ngjashme me Shqipërinë).

Edhe pse kapitali i huaj krijoi ndërmarrje të reja në Hungari, e më pas në Çeki e Sllovakia, kompanitë shumëkombëshe që vepronin në rajon tentonin të shmangin Slloveninë, pavarësisht nivelit të saj të lartë të zhvillimit dhe pozicionit gjeografik të favorshëm.

Avantazhet krahasuese të Sllovenisë bazuar në zhvillimin strukturor të Sllovenisë, cilësia e lartë e produkteve që eksportonte, rrjetet e shërbimeve dhe tregtisë të krijuar më parë dhe pozicioni gjeografik filluan të kishin një efekt më të vogël tek investitorët e huaj për shkak së këta të fundit duke punuar në vende si Hungaria, filluan të ofronin produktet dhe shërbimet në të njëjtën cilësi por më çmime më të ulta.

Për më tepër, mjaft kompani të teknologjisë së lartë zgjodhën të hidhnin produktet e tyre rajonale në vende të tjera të Evropës Qëndrore. Megjithëse Sllovenia arriti të mbante një pjesë të tregut Gjerman me eksportet e veta, nuk mundi të arrinte në nivelet e eksporteve të Hungarisë dhe Çekisë e të Sllovakisë të cilat u rritën me shpejtësi.

---

<sup>3</sup> *Sllovenia - nga -Jugoslavia në Bashkimin Evropian, Banka Botërore, 2004*

*Arsyet që theksuan rëndësinë e anëtarësimit të Sllovenisë në BE, janë të ngjashme me ato të një sërë vendesh të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore*

- *Së pari*, ato shpresojnë të marrin një zhvillim më të madh ekonomik-social dhe siguri ushtarake, një stabilitet të kuadrit ligjor dhe institucione të forta demokratike. Ky faktor ishte mjaft i rëndësishëm për Slloveninë, veçanërisht për sa i takon arsyeve që lidhen me sigurinë e jashtme.

- *Së dyti*, një sërë argumentash ekonomikë flasin në favor të anëtarësimit të tilla si: tregtia e lirë e produkteve, në kushtet kur do të përdreshin klauzolat e mbrojtjes së tregtisë dhe produkteve të BE-së për sa i përket rregullave të tregtisë së lirë. Gjithashtu, anëtarët e rinj të BE-së bëhen pjesë e tregut të brendshëm të BE-së duke ndikuar në rritjen ekonomike dhe përmirësimet strukturore. Së fundi, tregtia ndërmjet vendeve të reja vetë, që ishte ndeshur deri në atë kohë nga pengesa bilaterale dhe sektorale (pavarësisht nga synimi origjinal i CEFTA) do të bëhet plotësisht e lirë në momentin e anëtarësimit në BE.

- *Së treti*, anëtarësimi në BE do të zvogëlojë barrierat në punësim.

- *Së katërti*, aksesit në burimet financiare të BE-së ka qenë gjithmonë një forcë drejtuese për anëtarësimin në BE për një sërë vendesh candidate. Sërish Sllovenia për shkak të nivelit të lartë të zhvillimit, dhe forcimit të valutës së saj nuk e konsideronte këtë faktor si më të rëndësishmin, por sigurisht ishte e interesuar të përfitonte nga kapitali i BE-së.

- *Së pesti*, i një rëndësie të madhe ishte fakti se vetëm anëtarësimi mund të zgjidhte problemin e Sllovenisë në qoftë se kjo do të varej nga vendimet e Brukselit, ku vendet jo anëtarë të BE-së nuk e kanë këtë mundësi.

Cilësia e lartë e administratës publike, një konsensus i gjerë politik në lidhje me hyrjen në BE, dhe mbështetja sociale e fortë duket se ishin edhe garancitë më të forta për një bashkërendim të interesave të Sllovenisë dhe qëndrimeve për anëtarësimin në BE.

Sipas ekspertëve dhe politikanëve të Sllovenisë, por edhe opinionit të gjerë publik aksesit në BE konsiderohet si një proces me rezultat pozitiv. Opinioni publik i Evropës Perëndimore i qëndron mendimit se përfitimet nga zgjerimi i BE-së shtrihen kryesisht në shtetet që anëtarësohen në BE, ndërkohë që kostot e anëtarësimit mbetet të ndahen kryesisht ndërmjet vendeve anëtare të BE-së. Sigurisht që këto vende nuk janë të informuara në lidhje me kostot për përgatitjen për anëtarësim në BE, ndërkohë që ato marrin mjaft përfitime nga zgjerimi i BE-së.

Një llogaritje e plotë e përfitimeve dhe kostove duhet të përfshijë një sërë treguesish cilësore të tillë si siguria, stabiliteti, parashikueshmëria

dhe besueshmëria, të cilët janë faktorë të rëndësishëm në procesin e vendimarrjes ekonomike, sociale dhe politike, por që vështirë se mund të maten.

Kostot reale të mungesës së sigurisë, stabilitetit dhe të tjerave mund të bëhen mjaft të dukshme në kushtet e proceseve që sjellin shkatërrim të procesit dhe marrjes së rezultateve negative.

Nga ana tjetër, përfitimet dhe kostot duhen parë të shtrira në disa sektorë. Kështu, në qoftë se nga hyrja në BE, disa biznese mund të sigurojnë fitime të menjëhershme, bizneseve të tjera do t'u duhej të ndërmerren një sërë investimesh dhe ristrukturimesh, me qëllim që të mund të mbijetonin në treg. Sipas Majcen (1999) grupi i parë është ai i sektorëve të orientuar drejt eksportit, ku efektet pozitive do të priteshin pavarësisht nga ndryshimi i kursit të këmbimit, financat publike ose politikat ekonomike. Grupi i dytë përfshin sektorë ku efektet negative priten pavarësisht politikave qeveritare të ndërrmarra (bujqësia, pyjet). Grupi i tretë përfshin sektorët ku efektet varen gjerësisht nga kursi i këmbimit dhe politikat e financave publike të ndjekura (të tilla si energjia, gazi).

Përfitimet dhe kostot do të shpërndahen në mënyrë të pabarabartë ndërmjet rajoneve. Veçanërisht në periudhën e menjëhershme të hyrjes në BE, rajonet më të zhvilluara janë ato që thithin më shumë përfitimet nga BE dhe që thithin burimet e BE-së më shpejtë dhe me më eficientë se sa rajonet e tjera. Kjo pabarazi e shfaqur dukshëm në vitin e parë, vjen duke u zvogëluar në periudhën afatmesme, duke qenë se aftësia e rajoneve më pak të zhvilluara për të thithur burime rritet. Sidoqoftë, politikat qeveritare të qarta që synojnë zvogëlimin e pabarazive ndërmjet rajoneve dhe ndarjeve shoqërore janë mjaft të nevojshme.

Përfitimet dhe kostot mund të shpërndahen në mënyrë të pabarabartë edhe në kohë. Përfitimet afatshkurtra nuk duket se rezistojnë edhe në periudhat afatgjate, por gjithsesi nuk mund të mendohet se përfitimet në periudhën afatshkurtër shndërrohen në humbje në periudhën afatgjatë. Gjithshka varet shumë nga përgatitja e vendit për të ndërmarrë procesin e reformave, shkallës së hapjes së ekonomisë ndaj vendeve të tjera, aftësive për të thithur burimet e BE-së si dhe inputet e brendshme. Eksperienca e përgjithshme ndërmjet vendeve që kanë hyrë në BE në të shkuarën është se përfitimet nga integrimi duket se shfaqen plotësisht vetëm pas disa vitesh.

Sidoqoftë, është mjaft e rëndësishme që këto procese reformash të paraprihen nga analiza ekonomike e politike të cilat do të vendosnin edhe shtyllat ku do të drejtoheshin reformat. Rritja e çmimeve, rritja e papunësisë, falimentimi i një sërë ndërmarrjesh të vogla e të mesme, rritja e gepit të zhvillimit ndërmjet rajoneve të ndryshme, dhe humbja e pavarësisë, do të ishin pjesë e një analize të thelluar ekonomike.

Çmimet do të synojnë drejt niveleve ndërkombëtare, si rezultat i tregtisë së lirë dhe liberalizimit të tregut dhe kapitalit në vendet që hyjnë në BE, megjithëse disa të mira dhe sidomos shërbimet do të përballen me një rritje shumë të vogël të çmimeve. Rritja e çmimeve mund të shkaktohet për një sërë faktorësh, si për shembull përshtatja e taksës mbi vlerën e shtuar në nivelet e BE-së, apo si rezultat i liberalizimit të menjëhershëm të disa sektorëve që për shkak të politikës shtetërore kanë qenë të mbyllur, qoftë si rezultat i mbajtjes në kontroll të çmimeve apo edhe për të subvencionuar një segment të shoqërisë që nuk arrin dot të marrë këto shërbime me burimet e veta.

Përsa i përket punësimin, hyrja në BE do të lehtësonte mundësitë e individëve për t'u punësuar në tregjet ku ka kërkesë për punë, dhe një sërë investitorësh të huaj mund të nxiten për të investuar aty ku fuqia punëtore është e lirë dhe e gatshme. Nga ana tjetër një sërë kompanish që kanë probleme me ristrukturimin dhe nevojën për investime kapitale do të përballen me rritje të papunësisë. Sigurisht që edhe ndërmarrjet e vogla do të ndikohen nga integrimi në BE. Kjo për faktin se kjo fazë e modernizimit të ekonomisë do të kërkojë një përqëndrim të kapitalit (të huaj dhe vendas), duke ndikuar në SME-të në bashkimin, shkrirjen apo falimentimin e disave prej tyre. Sidoqoftë, nga ana tjetër kjo duhet kuptuar si një tendencë drejt zhvillimit të kompanive të fuqishme e të qëndrueshme, kundrejt atyre kompanive të dobta e të paqëndrueshme që ekzistojnë më parë. Është e vështirë të kuptohet se si kompani vendase që synojnë vetëm një treg të vogël të brendshëm të mos përfitojnë nga hapja e tregut me 450 milion konsumatorë.

## **4.2 EFEKTI I INTEGRIMIT NË BE TEK E ARDHMJAE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

Është e qartë se hapat e tjerë të modernizimit ekonomik do të kërkojnë një përqëndrim të kapitalit (qoftë ai i brendshëm apo i jashtëm) i cili do të ndikojë në një sërë ndërmarrjesh të vogla e të mesme. Bashkimet, shkrirjet, fillimet dhe falimentimet e një pjese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dominojnë situatën në periudhën e parë të hyrjes në BE. Megjithatë, kjo do të ishte e nevojshme edhe në qoftë se nuk do të ishte rasti i hyrjes në BE. Në këtë kuadër hyrja në BE mund të konsiderohet si një faktor katalizues<sup>4</sup> për të pastruar tregjet e për të nxitur konkurrencën ndërkombëtare.

Me përjashtim të disa sektorëve të mbrojtur, dhe disa kompanive të lidhura me shërbimet, të gjithë aktorët ekonomikë në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore janë përballur me konkurrencën e lirë për disa vite me rradhë. Në këto kushte ata janë në gjendje të mbijetojnë edhe në qoftë se do t'u duhet të përshtaten me kërkesat e reja.

Megjithatë nuk mund të përfshihen të gjitha SME-të në një kategori e t'u vendosen të njëjtat karakteristika përsa i përket reagimit ndaj konkurrencës ndërkombëtare. Kështu, parukieret që operojnë në Shtutgart për shembull nuk mund të mendojnë të shkojnë të hapin një sallon bukuri në Slloveni, ose në Shqipëri, thjesht për një interes të të bërit biznes, pasi klientela e tyre është e përcaktuar. Disa kompani të tjera janë të bazuara në tregun e brendshëm dhe nuk interesohen për prodhim për eksport. Disa të tjerë do të shihnin mundësinë e eksportimit të produkteve si mjaft fitimprurëse, dhe disa të tjerë do të shndërroheshin në nënkontraktorë të kompanive shumëkombëshe.

Ato kompani që gëzonin reputacion në treg si rezultat i ekonomisë së mbyllur do të ndodhen në vështirësi, por jo në një situatë të pashpresë për të arritur të përfitojnë nga procesi i integritimit në BE.

Pra, së fundi, përsa i takon kësaj pike mund të thuhet se ndryshimet strukturore në sektorin e SME-ve vijnë si rezultat i presioneve të zhvillimit ekonomik dhe arritjes së avantazheve krahasuese ndërkombëtare.

---

<sup>4</sup> EU membership, Costs, Benefits and Rationale, Andras Inotai, Peter Stanovnik, World Bank

Kjo është edhe ajo çfarë Sllovenia duhej të mbante parasysh e mbi të gjitha të diskutonte në shkallë të gjerë me komunitetin e biznesit, për ta përgatitur për rezultatet që do të merreshin.

Një situatë e ngjashme ekziston edhe në Shqipëri, që me nënshkrimin e marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e Rajonit, që tek e fundit shërben si një trampolinë për t'u përshtatur drejt integritit në BE dhe kushteve të tregtisë me të.

### 4.3 MADHËSIA E SHTETIT ADERUES DHE RËNDËSIA E TIJ NË ANËTARËSIMIN NË BE

Në fillim të viteve '90 Bashkimi Evropian e gjeti veten disi të pa përgatitur ndaj mënyrës se si vendet e ish kampit socialist, që në atë kohë dalloheshin me termin vendet e Evropës Lindore do të hynin në BE. Mbas 15 vjetësh, përgjigja është e thjeshtë, BE ndodhet para një dyndje të vendeve të ish-kampit socialist- përfshirë dhe Sloveninë. Anëtarësimi në BE mund të konsiderohet si një shpërblim për të gjitha përpjekjet e bëra nga ky vend për të investuar në ngritjen e tij si një aktor në komunitetin ndërkombëtar. Megjithatë, anëtarësimi në BE është edhe një sfidë për Slloveninë për të vazhduar strategjinë e saj dhe përmbushjen e qëllimeve të vendit.

*Për çfarë ishte e përgatitur Sllovenia nga anëtarësimi në BE?*

Historia e Bashkimit Evropian është ndërmjet të tjerash histori e anëtarëve të vegjël dhe e partnerëve të mëdhenj. Sidoqoftë, parimi i përgjithshëm që rregullon marrëdhëniet institucionale ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, edhe në rastet kur mund të mendohet se ekzistojnë argumente të kundërta ndërmjet shteteve të mëdha dhe atyre të vogla, është ai i të qenit të paanshëm. Pra e thënë ndryshe, ajo që duhet të qëndrojë në respekt të rolit të shteteve anëtare në një sistem vendim marrës ndërkombëtar si Bashkimi Evropian, është një pikë balance ndërmjet dy barazive- barazisë formale, që mendohet të ketë ekzistuar që në traktatin e Westphalise në 1648 dhe zbatimin e të cilës ndjekin të gjithë vendet anëtare të BE-së, dhe barazia aktuale, që nuk ka ekzistuar kurrë dhe që duhet nxitur gjithmonë nëpërmjet marrëveshjeve (Sabic 1999).

Sllovenia është një nga shtetet e vogla që ka mësuar nga mënyra e anëtarësimit në BE. Një nga këto mësimë është se megjithëse çështjet institucionale kanë rëndësi, ato janë ndoshta fusha e vetme në politik-bërjen e BE-së që mund të sjellin shtetet e vogla bashkë si një grup, veçanërisht në qoftë se ata ndejnë rrezikun e të qenit grup i marxhinalizuar kundrejt shteteve të mëdha. Tek e fundit BE është një bashkim shtetesh të cilët ruajnë anëtarësinë e tyre për sa kohë që nuk ndihen të cënuara apo të trajtuara padrejtësisht. Perceptimi i një balance ndërmjet barazisë

formale dhe aktuale është thelbi i një traktati të tillë. Në qoftë se kjo nuk do të ekzistonte, BE do të shkonte drejt shkatërrimit.

Fleksibiliteti i vendeve si Sllovenia në kërkim të bashkëpunimit dhe ndihmës, që përcaktohet nga ajo se çfarë dëshiron të arrijë në të vërtetë një vend në fushën e bashkëpunimit me vendet e BE-së është edhe drejtimi kryesor strategjik i tyre. Ministri i Jashtëm i Irlandës, Brian Cowen, e ka përshkruar qëllimin e tij si më poshtë:

“Ne kemi ngjashmëri me vende si Suedia dhe Finlanda sa i takon sigurisë dhe mbrojtjes. Pikëpamjet tona lidhur me Komisionin koincidojnë me ato të vendeve të BENELUX-it. Ne bashkëpunojmë me Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me tatimet dhe me Francën në lidhje me Bujqësinë”<sup>5</sup> Cilat janë ose mund të jenë prioritetet imediate për Slloveninë si një vend anëtar i ri i BE-së? Po Shqipëria a mundet të marrë në konsideratë mësimet e nxjerra nga Sllovenia sa i përket anëtarësimit në BE në të ardhmen?

Së pari, Slovenia duhet të mësonte të thithte sa më shumë të ishte e mundur oportunitetet e një tregu të madh e të hapur dhe t’i përshtatej këtij tregu nëpërmjet një ristrukturimi të përshtatshëm drejt konfigurimeve të reja si dhe faktorëve të rinj të prodhimit.

Sidoqoftë, është mjaft e rëndësishme të njohësh sfidat, por mbi të gjitha të mund të shohësh përtej tyre. Në këto kushte, Slovenia nuk duhet të humbë nga sytë ato vende që presin anëtarësimin e plotë në BE.

Përcaktimi i një rruge të qartë për zgjerimin në të ardhmen, me qëllim krijimin e një mbështetjeje ekonomike e politike të nevojshme për të ndërmarrë reformat e duhura duhet të jenë prioritet për Slloveninë, por edhe për BE-në.

Shtyrja e zgjerimit të BE-së dhe kalimi nëpër procesin e stabilizim asociimit, sigurisht që do të thotë shtyrje e transformimit dhe progresit jo vetëm për vendet candidate për në BE por edhe për ato që janë anëtare të saj.

Prioriteti i dytë që duhet të merret në konsideratë nga vende të vogla, siç ishte Sllovenia, apo siç është edhe Shqipëria, është zgjidhja e strategjive të duhura të specializimit, për të gjetur pikat e ‘forta’ në të cilat ekspertiza e tyre do të kishte avantazhe të larta konkurruese (Sabic 2002). E ardhmja e vendeve të vogla si Sllovenia në BE nuk përcaktohet

<sup>5</sup> Le Monde, 4 Prill 2003, i përmendur nga MAgnette dhe Nicolaidis (2003), përmendur në *Slovenia - nga Jugosllavia në Bashkimin Evropian, Banka Botërore, 2004*

nga madhësia e tyre. Përkundrazi, madhësia nuk mund të konsiderohet si një handicap. Specializimi në ekonomi dhe politikë është një nga disa avantazhe që vendet e vogla kanë në një ekonomi gjithnjë e më shumë globale. Me hyrjen në BE vendet e vogla fitojnë fuqi strukturore dhe racionale. Në qoftë se ato do të kishin sukses në specializimin e tyre, ato mund të merrnin pushtet e të ndikonin në të mirë të tyre, siç është rasti i Luksemburgut dhe Irlandës. Të tilla fusha specializimi për Slloveninë do të ishin: Marrëdhëniet me vendet e Ballkanit – kjo është një zonë që vazhdon të mbetet nga zonat me prioritet për BE-në. Sllovenia duke qenë pjesë e ish republikës Jugosllave, ka njohuri të mjaftueshme për këto vende ‘si motra’ të saj në Ballkan. Në këto kushte, ajo do të luante një rol të madh pozitiv në ndryshimin e drejtimit të politikave pritëse drejt atyre proaktive.

Një tjetër fushë e specializimit është mënyra e trajtimit të çështjeve të minoritetit – një fushë ku Sllovenia ka eksperiencë dhe mund të ndihmojë arritjen e standarteve të BE-së (Roter 2003)

Prioriteti i fundit por gjithashtu i rëndësishëm do të ishte që Sllovenia të përpiqej të krijonte një mjedis të brendshëm të fortë, të qëndrueshëm që të mund të mbështeste vendin në realizimin e aspiratave ndërkombëtare.

Duke iu referuar Katzenstein (1985) dhe Kindleberger (1984), del e qartë se: qëllimet që i vendos vetes një shtet i vogël mund të arrihen vetëm në qoftë se ekzistojnë themele të qëndrueshme, aftësia për të arritur një kohezion social më të mirë, një marrëdhënie pune, kapital më të mirë-strukturuar dhe një zbatim më të mirë të politikave.

Që në vitin 2004, kur Sllovenia u anëtarësua në BE, fatet e saj përcaktohen jo vetëm nga mjedisi i ri- zgjerimi i BE-së por njëkohësisht edhe nga veprimet e ndërmarra nga politikbërësit në vendin e tyre. Asgjë nuk do të ishte e nevojshme për t’u specifikuar ndryshe sa i takon prioritetet, që Shqipëria si një vend i vogël, që ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në në vitin 2005, do të duhej t’i vinte vetes me qëllim që të përmbushte qëllimin e vendit për anëtarësim në BE.

Fakti që Procesi i Stabilizim Asociimit vazhdon ende është një tregues, që Shqipëria duhet të punojë akoma për të krijuar themelin e qëndrueshëm, të brendshëm, për të qenë në gjendje për t’iu përshtatur zgjerimit të BE-së në të ardhmen.

EBRD vlerëson progresin e vendeve në tranzicion nëpërmjet një grupi treguesish të tranzicionit. Kjo metodë është përdorur për të ndjekur hapat

e zhvillimit në të gjitha vendet që nga fillimi i tranzicionit. Sigurisht që shkalla e progresit matet kundrejt standarteve të vendeve të industrializuara, pa mohuar faktin që në koncept pranohet se nuk ka ekonomi tregu të pastër dhe nuk ka një pikë fundore unike për tranzicionin.

Vlerësimi i bërë sipas shkallës 1-4+ shërben për të treguar ecurinë, ku 1 paraqet pak ndryshim ose aspak nga një ekonomi e centralizuar dhe 4+ paraqet standartet e një ekonomie tregu të industrializuar.

Analiza përqëndrohet në vlerësimin e treguesve në këto fusha të rëndësishme: privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha, privatizimi i ndërmarrjeve të vogla, liberalizimi i çmimeve, qeverisja dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve, sistemi i këmbimit të valutës dhe i tregtisë me jashtë, politika e konkurrueshmërisë, sistemi bankar, liberalizimi i normave të interesit, tregjet e sigurimeve dhe institucionet financiare jo-bankare si dhe infrastruktura.

### SHQIPËRIA

**Sipërfaqja:** 28000 km<sup>2</sup>

**Popullsia:** 3.2 milion banorë

**Vendndodhje Gjeografike:**

Gadishulli Ballkanik, Pjesa

Perëndimore

**Ndryshimi i regjimit politik:**

1992

**Sistemi:** Republikë

Nënshkroi MSA-në me BE-në në

vitin 2005

### SLLOVENIA

**Sipërfaqja:** 20000 km<sup>2</sup>

**Popullsia:** 2 milion banorë

**Vendndodhje Gjeografike:**

Gadishulli Ballkanik


**Ndryshimi i regjimit politik:**

1989

**Sistemi:** Republikë

Anëtaresohet në BE në vitin

2004



## Sllovenia si një vend kufitar me vendet e Bashkimit Evropian

Si një rezultat i zgjerimit, BE ka aktualisht dy lloj kufijsh- kufij të fortë dhe kufij të dobët. Tek kufijtë e fortë përfshihen ato kufij që ndahen ndërmjet vendeve të BE-së dhe Rusisë, Bjellorusisë, Ukrainës, ndërkohë që kufij të dobët janë ato me vendet kandidatë për në BE. Deklarata e Selanikut, e vitit 2003 mbi Vendet e Ballkanit Perëndimor, duke iu orfuar atyre mundësinë për t'u anëtarësuar në BE, e ka bërë edhe më të dukshëm dallimin.

Politika gjeografike e Sllovenisë, biodiversiteti, afërsia me Alpet dhe detin Adriatik i kanë krijuar mundësi Sllovenisë që të vlerësojë më shumë avantazhet e saj në një zonë të BE-së. Integrimi sigurisht që nuk kupton vetëm marrëdhënie më të afërta ekonomike me vendet e BE-së (në tregti, investime, zonën e Euros, politikat fiskale, lëvizjen e kapitalit, bashkëpunimin rajonal, të teknologjisë dhe në fushën e kërkimeve), por edhe në intensifikimin e lidhjeve politike dhe kulturore dhe harmonizimin me vendet fqinje dhe të rajonit.

Duke u nisur nga mundësitë dhe rrisqet e zgjerimit dhe rajonalizimit, është e qartë që Sllovenia duhet të ndjekë një strategji zhvillimi që do të:

- lejojë një rritje ekonomike të qëndrueshme duke theksuar mjaft synimin për të arritur vendet e BE-së;
- të fokusohet në një vizion të përbashkët për një ekonomi rajonale të integruar, përfshirje sociale dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë në Rajon;
- të sigurojë infrastrukturën që do të bëjë kalimin e kufijve më të lehtë dhe të orientohet drejt integritit të kufijve të rajonit;
- të marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit, burimeve natyrore dhe nevojave të popullsisë vendase; dhe
- të ndihmojë në krijimin e institucioneve ndërkufitare për shkëmbimin e kulturave dhe zhvillimin rajonal.

Hyrja në BE i sjell Sllovenisë dhe fqinjëve të saj në rajon mundësitë për rritjen dhe zhvillimin ekonomik në një shkallë të lartë; mundësinë për të zgjeruar tregjet në vendet fqinje; arritjen e përfitimeve nëpërmjet produkteve të integruara (zinxhiri i prodhimit në vendet fqinje).

Nga ana tjetër, rrisqet lidhen me: humbjen e tregjeve me pakicë për një sërë produktesh për shkak të konkurrencës nga tregjet e huaja, ndryshimet

e çmimeve, përballja e sektorëve të SME-ve, ndërtimit, shërbimit me konkurrencën e vendeve të BE-së, përfshirja e punëtorëve nga vende të tjera fqinje në fuqinë punëtore të vendit në fjalë, rrezik i migrimit të trurit dhe i humbjes së fuqisë punëtore të kualifikuar drejt vendeve të tjera të rajonit.

Gjatë periudhës së tranzicionit për të hyrë në BE, Sllovenia përfitoi një përvojë të madhe në një sërë fushash, si: zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional, ngritja e kapaciteteve, mundësia e pjesëmarrjes në Programet Evropiane. Të gjitha këto shërbejnë si instrumenta në transferimin e njohurive në vendet e reja kandidatë të Evropës Juglindore.

**Tabela 1: Tregues të caktuar të Ekonomisë Sllovene në vitet 1991-2004**

<b>Treguesi</b>	<b>1991</b>	<b>2004</b>
Sipërfaqe	20.2	20.2
Popullsi (në mijë)	1,996	2,000
Punësimi (në mijë)	-7.8	2.9
Papunësia	7.3	6.4
PBB për frymë (EUR)	6,339.90	16,650.40
Borxhi i jashtëm (mil.USD)	1,753.90	12,196.80
Norma e borxhit ndaj exporteve (përqindje)	31	97.6
Norma e borxhit ndaj PBB (përqindje)	15	57.5
Exportet e mallrave dhe shërbimeve (në përqindje të PBB)	-20.1	12.5
Importet e mallrave dhe shërbimeve (në përqindje të PBB)	-22.4	13.3
Pjesa e Industrisë në PBB (në përqindje)	39.9	24.9
Pjesa e Bujqësisë në PBB (në përqindje)	5.7	2.3
Konsumi Privat	-10.9	-10.9
Konsumi Publik	-0.3	-0.3
Investimet e Huaja Direkte	-41.3	281.1
Indeksi i çmimeve të konsumatorit (IÇK)	115	3.6

*Burimi: EBRD, Transition Report 2007*

**Tabela 2: Prodhimi industrial si pjesë e PBB-së**

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
<b>Shqipëria</b>	32.1	16.9	10.2	10.2	10.2	9.6	9.8	9.4	8.4	8.2	7.8	7.7	7.5	7.3	7.1
<b>Slllovenia</b>	39.9	35.9	33.4	34.7	29.9	25.4	25.8	26.3	25.4	25.6	25.9	25.3	25.4	24.9	23.9
<b>Slllovakia</b>	35.2	29.3	29.3	24.6	29.1	29.5	26.8	25.5	24.6	25.5	25.2	23.5	24.3	25.9	25.6
<b>Polonia</b>	40.2	34	32.9	32.2	32.1	30.8	30.7	30.3	29.7	31.7	29.5	28.7	29.6	30.8	30.7
<b>Hungaria</b>	21	20.4	21.3	21.9	23.1	23.5	25	25.9	26.7	27.3	26.6	26.1	26.7	26.5	26.6
<b>Sërbia</b>							26	26.1	25.5	26	27.2	34.3	26	25.7	24.6
<b>Rumania</b>	49.4	38.3	33.8	36.2	32.9	34.2	35.6	26.3	24.8	27.3	28.2	28.4	25	24.7	24.1
<b>Macedonia</b>		27.1	25.6	24.3	19.6	19.5	19.9	19	18.4	18.1	17.5	17.2	17.6	16.5	17
<b>Republika Çeke</b>	37.9	39.4	33.3	33.6	33.3	33.8	35.9	36.9	35.5	36	37.5	37.5	38.2	40	40.1
<b>Kiroacia</b>					22.8	21.6	21.9	21.1	20.7	20.7	20.4	19.4	19.5	20.2	20.7
<b>Bullgaria</b>	39.8	39	32.7	30	31	29	25	22.3	25.1	25.8	25.2	25.6	20.6	26	26.1

**Tabela 3: Prodhimi Bujqësor si pjesë e PBB-së**

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
<b>Shqipëria</b>	42.5	54.2	33.8	30.6	28.6	29.8	24.8	28.8	34.1	32.2	32.2	28.4	27.6	26.8	26.4
<b>Slovenia</b>	5.7	5.8	5.1	4.5	4.2	3.4	3.5	3.3	2.8	2.7	2.5	2.7	2.2	2.3	2.2
<b>Slovakia</b>	5.7	5.4	5.9	5	4.7	4.4	4	4	4.2	4.5	4	3.6	4	3.9	
<b>Polonia</b>	6.8	6.7	6.6	6.2	5.6	5.2	4.5	3.9	3.2	3	3.2	2.7	2.6	2.5	2.5
<b>Hungaria</b>	7.8	6.5	6.1	5.9	5.9	6.1	5.8	5.4	5.3	4.5	5	4.4	4.2	6.1	5.8
<b>Sërbia</b>							29.4	19	25.1	17.6	17.2	19.3	13.7	15	13.5
<b>Rumania</b>	23.6	19	21	19.9	19.8	19.1	18.8	14.4	13.3	11.1	13.3	11.3	11.6	12.8	8.5
<b>Macedonia</b>	9.4	8.2	9.1	10.6	10.7	10.9	11.4	11	10	9.8	9.5	9.7	9.8	9.7	
<b>Republika Çeke</b>	5.6	4.6	5.3	4.9	4.7	4.9	5	4.8	3.9	3.9	3.7	3.8	3.4	3.3	3.3
<b>Kroacia</b>					8.6	8.4	7.8	7.9	8.1	7.4	7.5	7.3	6	6.5	6.3
<b>Bullgaria</b>	15.4	11.6	9.9	11.5	12.7	14.2	23.4	16.8	14.5	12.3	12.1	10.7	10.1	9.4	8